

VENDIM
Nr.3, datë 2.2.2015

PËRKUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “FATLUM”
SHPKNGA HEC “PËRROLLAJ”,ME FUQI 0.5MW

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa“l”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3, pika 1,germa“f”, të ligjit nr. 138/2013, datë 2.2.2013, “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”; nenit 9 pika 1 dhe pika 2 germa“a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007,Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Fatlum” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues nga HEC “Përrollaj” me fuqi 0.5 MW.

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “FATLUM”sh.p.k., është plotësuar konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme,si më poshtë:

- Neni 7, pika 1,germat “a”, “b”, “c”, “d” - plotësuar tërësisht.
- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”
- Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.
- Neni 7 pika 3, germat “a”, “b”, “c”.
- Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Fatlum”sh.p.k.,si burim i rinovueshëm energjie nga HEC “Përrollaj” me fuqi 0.5 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti